



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2464/16 Prot.

Tiranë, më 05.10 2023

V E N D I M

Nr. 108 datë 05.10 2023

" P Ë R
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFËS SË KONTROLLIT TË TESTIT FIZIK
SPECIFIK, PËR STUDENTËT QË KANË REZULTUAR FITUES DHE JANË
RREGJISTRUAR NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE TË PROGRAMIT
BACHELOR PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Bazuar në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH" të nenit 3, të nenit 6, të nenit 38, në Statutin e UST, neni 7 .20, në Rregulloren e UST-së, në shkresën e FSHL nr. 2381 datë 29.09.2023, në Vendimin e Senatit nr. 79 date 14. 07.2023, në Vendimin e B.A. nr. 53 datë 19. 07.2023 "Për miratimin e kontrollit të testit fizik specifik për përballimin fizikisht të programit të studimit për studentët fitues në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 05.10.2023,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tarifën për kontrollin mjekësor: PWC që kryhet nëpërmjet biçikletës ergometrike MONARK, matjen e peshës dhe lartësisë trupore, për të gjithë studentët e Ciklit të parë të programit bachelor, që kanë rezultuar fitues dhe janë rregjistruar në vitin akademik 2023-2024, në FSHL dhe FVFR në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Tarifa të jetë në shumën 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, FSHL, FVFR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Agron KASA

